



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

<b>Drejtoria</b>	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
<b>Periudha raportuese</b>	Muaji Nëntor 2022
<b>Emri dhe mbiemri i raportuesit</b>	Znj. Donika Cetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

**1. PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Nëntor, realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për rekultivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushes së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Hortikultura”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Përgaditja dhe inicimi i projekteve për tenderim për krijimin e hapësirave të reja rekreative brenda qytetit të Prishtinës;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

### **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA:**

- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe rekreative në kryeqytet;
- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”, krasitja e drunjëve dhe prerja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre dhe pune të tjera të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave të gjelbërta;
- Krasitja e degëve të drunjëve të cilat paraqesin probleme pas pranimit të kërkesave nga qytetarët.
- Implementimi i punimeve të Parkut të Standardit
- Implementimi dhe fillimi i punimeve në Xhepin Urban – Parku Arberi
- Pastrimi i terrenit ku do të ndërtohet parku në rrugën “Sylejman Vokshi”
- Mbjelljet e drunjëve në rrugën Sylejman Vokshi
- Mbjellja e drunjëve në shiritat skajor të rrugës B
- Mbjellja e qeporeve në rrethin tek Muharrem Fejza
- Mbjellja e drunjëve dekorative dhe pishave të Emona Center, Bregu i Diellit
- Mbjellja e pemëve dhe shkurreve në hapësirën e gjelbërt në rrethrotullimin të Maxi 24
- Mbjellja e drunjëve dhe qeporeve në rrethrotullimin e Rrugës C
- Mbjellja e drunjëve, shkurreve dhe qeporeve në rrethin tek Viva Fresh
- Mbjellja e drunjëve dekorativë të banesat e bardha-Bregu i Diellit
- Mbjellja dhe Krasitja e drunjëve tek Mjekësia Sportive
- Mbjellja e drunjëve dhe shkurreve në parkun Adem Demaci
- Mbjellja e 40 drunjëve dekorativë përgjatë rr. Agim Ramadani
- Mbjellja e drunjëve dekorativë të Policia-Stationi Verior ( Arberi )
- Mbjellja e drunjëve dekorativë dhe pishave tek Hendikosi
- Mbjellja e drunjëve dekorativë dhe pishave në hapësirën e Fakultetit të Historisë - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -**

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe mbjelljen e tyre nga ana e NPL “Hortikultura”;
- Përcjellja dhe mbikëqyrja e punimeve në Parkun Linear – Lagjia e Spitalit;
- Fillimi i implementimit në Xhepin Urban – Parku Arberi
- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;

### **5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim të sipër**

Numri i lëndëve të pranuar:20

Numri i lëndëve të kryera:14

Numri i lëndëve të refuzuara: 2

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 4

## **6. Takime të tjera:**

- Takim me Marakli të Bicikletve, për shfrytëzimin e shtegut në Parkun e Gërrmisë.
- Takim me Youth Are The Real Leaders (YARL), për vendosjen e këndit të lojrave për fëmijë me nevoja të veqanta
- Diskutim me Dardan Zhegrova CHWB për ekspoziten Bunkeri në Ulpian
- Takim me Ekoz për mbjelljen e fidaneve ( donacion )
- Vizitë arkiva e shtetit
- Takim me Utalaya, për vendosjen e shportave në Parkun e Taukbashqes
- Takim me Ambasadën Japoneze për mundësi të bashkëpunimit për rigjenerim të sipërfaqes gjelbëruese
- Takim me delegacionin e Bankës Botërore, për Parkun Botanik

## **7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –**

- Organizimi dhe kordinimi i planeve operacionale dhe përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen dhe mbjelljen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”;
- Inagurimi i fillimit të punimeve në Parkun Vertikal tek nën rrethrotullimi për Fushë Kosovë
- Inagurimi i fillimit të punimeve në Parkun Rr.Sylejman Vokshi